



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1404/ 2 prot.,

Datë 04.06.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM  
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR  
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ARTEO 2018” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-04209-05-09-2024, me objekt “Blerje materiale elektrike”, me fond limit: 9,994,647 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 21.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SH.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “ARTEO 2018” SHPK *me Nipt. L82523203F. Adresa: Lagjja Luigj Gurakuqi, Bulevardi Aqif Pasha, Hotel Skampa, kati 5 nr.303, Elbasan.*
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SH.A.  
*Adresa: Lagjja: “Brigada XVII Sulmuese”, Rruga: “Petraq Popa” Elbasan.*

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2024/4147 datë 03.06.2024 dhe me Nr. 1404/2024 Prot., date 03.06.2024 e operatorit ekonomik “ARTEO 2018” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. 04209-05-09-2024, me objekt “Blerje materiale elektrike”, me fond limit: 9,994,647 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 21.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SH.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “ARTEO 2018” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit si më poshtë vijon:

**Arsyet e skualifikimit:**

-OE, “Arteo 20218” shpk, me NIPT: L82523203F, nga dokumentacioni i kërkuar për kualifikim, nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë, sipas të gjitha kërkesave të Autoritetit Kontraktor, dhe nuk përmbush:

1. “2.6 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues në ditën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë mostra për mallrat objekt prokurimi. Mosparaqitja e tyre përbën kusht për s’kualifikim.”

2.4 OE duhet të jetë i certifikuar dhe të disponojë certifikatat: b) ISO 14001:2015 për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit;

Certifikata në asnjë nga fushat e saj nuk përmend artikujt për tregti me shumicë dhe pakisë për materiale elektrike, objekt i këtij prokurimi.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 04.06.2024

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**

**Gjergj Mersini**

**Anëtar**

**Anila Malaj**

**Kryetar**

**Jonaid Myzyri**